

FTESË PËR TENDERIM
KOSOVË
Projekti i Transportit Urban të Prishtinës
FTESË PËR TENDER
për

Blerjen e 30 autobusëve dizel me hyrje të ulët në përputhje me standardin EURO-VI

Kjo Ftesë për Tenderim pason Lajmërimin për Prokurim të Përgjithshëm për këtë projekt, i cili është publikuar në webfaqen e BERZH-it. Lajmërimet për prokurim (www.ebrd.com) më 20 shkurt 2015.

Komuna e Prishtinës tash e tutje e quajtur si “Blerësi”, ka për qëllim të përdorë pjesën e një huaje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (e quajtur prej këtu Banka), ndaj kostos së Projektit Transporti Urban i Prishtinës.

Blerësi tani bën ftesë për tender të mbyllur nga Furnizuesit për kontratën në vijim e cila do të financohet nga pjesë të huasë:

- **Furnizimi me Autobusë Dizel**

I cili përfshin prokurimin e 30 autobusëve dizel me hyrje të ultë dhe në përputhje me standardin EURO VI, si edhe pjesët rezervë të detyrueshme dhe pjesët e materialit harxhues, me dorëzim opcional të 21 autobusëve tjerë shtesë me hyrje të ulët dhe sipas standardit EURO VI së bashku me pjesë rezervë të detyrueshme dhe të pjesëve të materialit harxhues.

Tenderimi për kontratë e cila do të financohen me huanë nga Banka është i hapur ndaj firmave të cilit do vend.

Për t'u kualifikuar për marrjen e kontratës, tenderuesit duhet të plotësojnë minimumin e kritereve në vijim:

- **Performancën historike financiare**

Pasqyrat e audituara të bilancit për pesë vitet e fundit duhet të dorëzohen dhe duhet të dëshmojnë saktësinë e pozitës financiare të Ofertuesit, duke dhënë edhe përfitimet afat-gjata. Aty ku është e domosdoshme, Blerësi do të bëjë kërkesa me bankat e Ofertuesit.

Kriteri 1: Vlera pozitive neto në të gjitha pesë vitet e kaluara

- **Qarkullimi mesatar vjetor**

Qarkullimi mesatar vjetor si Furnizues kryesor (definuar sipas ligjit për Të mira dhe Shërbime të dhëna dhe në proces e sipër) gjatë 5 viteve prej **18,000,000.00 EURO (tetëmbëdhjetë milion EUROVE)** apo ekuivalenti;

- **Resurset financiare**

Ofertuesi do të dëshmojë se ka qasje në apo ka në dispozicion, asete likuide, asete reale të pazotuara, linjën e kredisë, dhe mjete të tjera financiare të mjaftueshme për të përmbushur prodhimin e qarkullimit të keshit për kontratë vlerësuar si jo më pak se **8,000,000.00 Euro (tetë milion Euro)** apo ekuivalente, duke marrë në konsiderim zotimet e ofertuesit për kontrata të tjera.

- **Përvoja**

Përvojë si furnizues, në së paku 3 (tre) kontrata brenda 5 (pesë) viteve të kaluara, secila në vlerë prej së paku **7,000,000.00 Euro [shtatë milion Euro]**, të cilat janë plotësuar në mënyrë të suksesshme dhe substanciale dhe që janë të ngjashme me Të Mirat e propozuara. Ngjashmëria do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat / teknologjinë apo karakteristika të tjera, siç janë përshkruar në Seksionin IV,

Kërkesat për Furnizim (siç janë: autobus prej 12 metrave të gjatë me hyrje të ultë apo dysHEME të ultë, të pajisur me së paku tipin EURO V Dizel të makinave).

Dokumentet për Tenderim mund të merren nga zyra në adresën e poshtëshënuar pas pagesës së pakthyeshme prej 200 Eurove, apo ekuivalentit në banknota të konvertueshme.

Pagesa duhet të bëhet në xhirollogarinë bankare në vijim:

Emri për Xhirollogarinë: Komuna e Prishtines Numri i xhirollogarisë: 1000 6502 3000 0067 Emri i Bankës: Central Bank of the Republic of Kosovo Adresa e Bankës: Garibaldi 33, 10000 Prishtina, Kosovo Swift Code: CBRKXKPRXXX IBAN: XK051000650230000067

Pas pranimit të evidencës së mirëfilltë për pagesën e pagesës së pakthyeshme, dokumentet do të shpërndahen përmes korierit, megjithatë, nuk mund të pranohet obligim për humbjen apo dërgesën e vonuar. Nëse kërkohet dokumentet gjithashtu mund të shpërndahen në mënyrë elektronike pas prezantimit nga tenderuesi të evidencës së mirëfilltë për pagesën e pakthyeshme. Në rast të mospërputhjes ndërmjet dokumenteve në kopje fizike dhe atyre elektronike, do të merret në konsiderim dokumenti në kopje fizike.

Të gjithë tenderët duhet të jenë të pajisur me një sigurim të tenderit në shumën prej **350,000.00 (treqind e pesëdhjetë mijë Euro)** apo ekuivalentin e saj në të holla të tjera të konvertueshme.

Tenderët duhet të dorëzohen në zyrën në adresën e poshtëshënuar në ose para 17 shtatorit 2015, *në ora 14:00 (koha lokale e Prishtinës)*, në të cilën kohë ofertat do të hapen në prezencë të tenderuesve përfaqësuesit e të cilëve zgjedhin të marrin pjesë.

Një regjistër i ofertuesve potencial të cilët kanë blerë dokumentet e tenderit mund të vëzhgohet në adresën e poshtëshënuar.

Ofertuesi mund të marrin informata të mëtutjeshme nga, dhe gjithashtu të inspektojnë dhe të marrin dokumentet e tenderit në, zyrën e paraqitur në vijim:

Z. Dardan Sejdiu
Komuna e Prishtinës
Zyra e Nën Kryetarit
Rruga e UÇK-së 2, 10000 Prishtinë, Kosovë
+ 381 38 234 944 ext. 1011
Email: dardan.sejdiu@rks-gov.net